Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo

Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve
Nacionalni Autoritet za Kvalifikacije
National Qualification Authority

Numër: 01/294
Datë: 07.05.2024

Në mbështetje të neneve 8, 9 dhe 16 të Ligjit Nr. 03/L-060 për Kualifikimet Kombëtare, Rregulloren Nr. 01/2020 për përcaktimin e procedurave për Aplikim të Institucioneve të Arsimit dhe Aftësimit Profesional për akreditim institucional, validim dhe aprovim të kualifikimeve sipas Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve dhe për aplikim të institucioneve që zbatojnë Njohjen e Mësimit Paraprak, neni 5 paragrafi 4, 5 dhe 6, si dhe nenit 6 paragrafi 1 të Rregullores Nr. 01/196 e punës e Këshillit Drejtues të Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve, Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve (AKK), në mbledhjen e mbajtur me datë 29.04.2024 nxjerr këtë:

V E N D I M

1. REFUZOHET aplikacioni/kërkesa Nr.01/802 e dt. 22.12.2023 e Institucionit "Uni Universum International College" me adresë: Rr. Hasan Prishtina, Konjuh- Lipjan 14.000, 33Republika e Kosovës, për akreditim dhe validim për kualifikimin: Operator i Robotikëve Industrial, Niveli IV i KKK.

2. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

A r s y e t i m

Institucioni "Uni Universum International College" me adresë: Rr. Hasan Prishtina, Konjuh-Lipjan 14.000, Republika e Kosovës ka parashtruar në AKK aplikacionin/kërkesën nr. 01/802 të datës 22.12.2023 për akreditim dhe validim të kualifikimit: Operator i Robotikëve Industrial, Niveli IV i KKK.

Ekspertet e AKK-së brenda afatit ligjor kanë marrë në shqyrtim për vlerësim aplikacionin e dorëzuar nga ana e Institucionit "Uni Universum International College".

Me datë 08.03.2024, ekspertet e AKK-së përmes emalit zyrtar bazuar në nenin 7 paragrafi 3 të Rregullores Nr. 01/521 për përcaktimin e procedurave për Aplikimin e Institucioneve të Arsimit dhe Aftësimit Profesional, për proces të akreditimit institucional, validim dhe aprovim të kualifikimeve, si dhe për aplikim të institucioneve që zbatojnë Njohjen e Mësimit Paraprak pas konstatimeve se aplikacioni nuk është i kompletuar sipas dispozitave ligjore në fuqi, kanë kërkuar nga institucioni që në afat prej një (1) jave ta përmirësojnë aplikacionin bazuar në udhëzimet e

eksperteve të AKK-së dhe të njëjtin pas plotësimit të mangësive të identifikuara ta dorëzojnë në AKK për vlerësim. Institucioni "Uni Universum International College" ka marrë nga AKK dosjen e aplikimi bazuar në rekomandimin e ekspertëve për përmirësim, dhe të njëjtën brenda afatit të dhënë e kanë dorëzuar në AKK.

Ekspertët e AKK- së me datë 20.03.2024 kanë hartuar raportin vlerësues për aplikacionin e Institucionit "Uni Universum International College" dhe kanë konstatuar se edhe pas rishikimit të dosjes në afatin e dhënë nga AKK pala aplikuese nuk ka bërë të gjitha përmirësimet e kërkuara.

Andaj, bazuar në nenin 7 paragrafi 2 dhe 7 të Rregullores Nr. 01/521 për përcaktimin e procedurave për Aplikimin e Institucioneve të Arsimit dhe Aftësimit Profesional, për proces të akreditimit institucional, validim dhe aprovim të kualifikimeve, si dhe për aplikim të institucioneve që zbatojnë Njohjen e Mësimit Paraprak ekspertet e AKK-së i kanë rekomanduar Këshillit Drejtues që aplikacioni të refuzohet.

Ekspertet e AKK-së në raportin vlerësues të aplikacionit të palës aplikuese kanë konstatuar se: Vlera e propozuar e kredive nga ana e institucionit aplikues si dhe përshkrimi i orëve nuk janë në harmoni, sepse institucioni ka aplikuar me 120 kredi të AAP, ndërsa numri i orëve 1878 orë është i barabartë me 94 kredi të AAP.

Sa i përket formatit të kualifikimit ekspertët e AKK-së pas vlerësimit të dosjes së aplikimit edhe pas kërkesës për përmirësim nga ana e institucionit kanë konstatuar se: Kualifikimi është ende i paqartë. Kualifikimi është një përzierje mes llojeve të kualifikimeve që bazohen në standardet e profesionit dhe kualifikimeve të kombinuara. Institucioni nuk e ka qartësuar qëllimin se a po aplikojnë për arsim dhe aftësim profesional apo vetëm për aftësim profesional. Kualifikimi ka shpërputhje me aplikacionin e validimit për çështjen e kredive dhe llojit te kualifikimit. Në aplikacion të validimit është kërkuar validim për Kualifikimet Kombëtare Profesionale" por në brendësi përmbajtja e kualifikimit i referohen kurrikules së MASHT e cila gjen zbatim tek Kualifikimet e Kombinuara, e po ashtu edhe orët e përshkruara në aplikacion nuk janë të harmonizuara me formatin e kualifikimit.
Tek përshkruesit e moduleve kredit janë llogaritur bazuar në kornizën e vjetër qe është një (1) kredit e barasvlershme me dhjetë (10) orë mësimore, kjo është gabim sepse sipas Kornizes Kombëtare të Kualifikimeve të fundit një (1) kredi është e barasvlershme me njezetë (20) orë mësimore.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi mund të paraqitet ankesa për rishqyrtim të vendimit sipas nenit 20, pika 1, 2, 3 dhe 4 e Udhëzimit Administrativ Nr. 35/2014, Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë. Ankesa kundër këtij akti administrativ i dorëzohet KD të AKK, në afat prej 15 ditësh pas pranimit të vendimit.

Dr. Besim Mustafa

Kryetar i KD të AKK-së

Vendimi u dërgohet:

1. IAAP "Uni- Universum Internacional College"
2. Arkivit të AKK-së.